




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Administratës
Periudha raportuese	Maj 2022
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Bersant Beka

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuar me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Bashkësive Lokale
2. Sektori për Punë të Kuvendit Komunal
3. Sektori i Gjendjes Civile
4. Sektori i Teknologjisë Informative
5. Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme (Logjistikës)
6. Sektori për Shërbim me Qytetar
7. Autoparku

1.Sektori I Bashkesive Lokale

Gjate kesaj peridhe raportuese ne lamine e sektorit te Bashkesive Lokale jane leshuar per nevojat e qytetareve rreth 988 vertetime.

Si dhe me Drejtorin e Drejtorise se Administrates kemi vizituar disa nga bashkesite lokale,per ti percjelle nevojat dhe problemikat e tyre e te ofrojme ndihmen tone ne menyre qe te jemi sa me transparente me qytetaret tane.

2.Sektor i Shërbimeve të Kuvendit Komunal

Punët dhe detyrat në Sektorin e Kuvendit, kryesisht ndërlidhen me organizimin dhe koordinimin e punëve brenda sektorit, si për ndarjen e punëve dhe në kujdesin për angazhimin e plotë të punëtorëve që këto punë të kryhen në mënyrën më të rregullt.

Gjatë muajit maj është mbajtur mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa, është punuar kryesisht rreth organizimit dhe përgatitjes së materialeve. Gjithashtu është mbajtur mbledhja e katërt e Kuvendit të Komunës së Prishtinës ku është punuar rreth organizimit dhe përgatitjes së materialeve, po ashtu rreth përgatitjes së materialeve për MAPL për shqyrtim të ligjshmërisë.

Së bashku dhe në koordinim me kryesuesin e Kuvendit dhe ekzekutivin e Komunës, janë kryer edhe punë të tjera, të cilat kanë të bëjnë me Sektorin e Kuvendit.

3.Sektori I Gjendjes Civile

Në procedurë administrative për këtë periudhë nga komisioni i gjendjes civile i sektorit të gjendjes civile janë nxjerrur **113** vendime per kërkesat e palëve të cilat kanë të bëjnë me çështje të ndryshme nga gjendja civile e që shprehur në numëra statistikor duket si në vijim:

- 1.Vendim për regjistrim të më vonshëm në RTHL..... 39
- 2.Vendim për regjistrim të më vonshëm në RTHV..... 14
- 3.Vendim për ndërrimin e emrit-mbiemrit personal.... 12
- 4.Vendim për korigjimin e emrit-mbiemrit personal.... 8
- 5.Vendim per korigjimin e të dhënave të tjera në RTHL
RTHM,RTHSH,RTHV..... 39
- 6.Vendim per refuzim të kërkesës..... 2
- 7.Vendim per anulim në RTHL,RTHM..... 2
- 8.Vendim per njohjen e vendimit te huaj.....1.
- 9.Anulim I vendimit.....//

Gjithësejt: 117 vendime,

Ndërsa përmes sistemit elektronik për periudhën 01.05.2022 deri 31.05.2022 janë lëshuar **32596** Cërtifikata.

Si dhe për këtë periudhë kohore jane lëshuar **71** dëshmi mbi dekjen.

4.Sektori I Teknologjise Informative

Gjatë muajit Maj 2022, Sektori për Teknologji Informative, ka kryer këto punë dhe ka afruar ofruar këto shërbime si vijon më poshtë:

1. **Kemi kryer shërbime softuerike dhe harduerike**, për administratën komunale dhe institucionet tjera të komunës:
 - instalimi dhe konfigurimi i sistemeve operative, programeve aplikative,
 - instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve për operim funksional në rrjetë,
 - instalimi dhe konfigurimi i printerëve, fotokopjeve, ploterëve, digjital senderëve etj,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemit të sistemit operativ dhe programeve aplikative,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve harduerike,
 - identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në rrjetin lokal (LAN)
2. **Jemi kujdesur për siguri në teknologji informative**, në rrjeta, aparate, sisteme dhe programe të cilat punojnë dhe ruajnë të dhëna të ndjeshme. Kemi bërë kopjet (backup) ruajtjen e të dhënave të rëndësishme nga bazat e të dhënave të ndryshme që kemi në komunë,
3. **Kemi mirëmbajtur Serverët** e komunës së Prishtinës ,
4. **Kemi bërë mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrjetit LAN** dhe sipas nevojës kemi bërë kyçjen e kabllove në kabinete, switch-a, dhe përcaktimi i porteve,
5. **Kemi vazhduar krijimin e llogarive ne e-mail-in zyrtar** për stafin e komunës, në bashkëpunim me Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI),
6. **Kemi mirëmbajtur e-kiosqet** e komunës së Prishtinës,
7. **Kemi mirëmbajtur sistemin e menaxhimit të radhës**
8. **Kemi bërë monitorimin e mbledhjeve të KK. Prishtinë** përmes teleprezencës,
9. **Përditësimi i informatave në web faqen zyrtare dhe Prishtina Online**, dhe publikimi i atyre informatave në gjuhë zyrtare.
10. **HelpDesk**, për stafin e komunës dhe institucioneve tjera komunale.

- ***Gjatë kë kemi shqyrtuar Draft Raportin e ZKA-së, për sistemin e Gjendjes Civile dhe rekomandimet si të veprojë komuna që në raportin e ardhshëm të mos na shfaqen të gjeturat e njëjta si në këtë raport.***

Kemi menaxhuar/administruar këtë projekte/sisteme:

- Menaxhimi dhe administrimi i sistemit të brendshëm Intranetit
- Mirëmbajtja e uebfaqes zyrtare të komunës së Prishtinës dhe PrishtinaOnline,
- Komunikimi online me qytetare nëpërmjet Prishtina Online,
- Publikimi i të të hyrave dhe shpenzimeve në Prishtina Open Data
- Mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të mbeturinave,
- Platforma digjitale për participim publik.

Kemi menaxhuar dhe mbikëqyrur këto kontrata:

- Kontratën e AQP-së “Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qera”
- Furnizimi me toner për nevojat e komunës së Prishtinës,
- Mirëmbajtja i sistemit të menaxhimit elektronik të automjeteve me pajisje GPS,
- Mirëmbajtja e e-kiosqeve.

5.Sektori I Sherbimeve te Pergjithshme (Logjistikes)

Ky sektor ka zhvilluar aktivitetin e tij në mbështetje të Planit vjetor të punës, në mbështetje të Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, dhe gjatë kësaj periudhe është bërë:

- Sigurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të Komunës,
- Mirëmbajtja e pajisjeve në sallën e Kuvendit të Komunës,
- Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore,
- Kryerja e punëve teknike rreth regjistrimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve të Komunës,
- Mbikëqyrja për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve të Komunës,
- Rregullimi i sistemit të klimatizimit në Komuna e Re në Arbëri.
- Rifunksionalizimi I banjos për personat me aftësi të kufizuar.
- Vendosja e foljeve të akullta në dritare tek pjesa e krijimeve të sporteleve të reja Komuna e Re në Arbëri.
- Largimi i ventilatorit I cili është në defekt I cili është marrë nga kompania për servisim.
- Sjellja e aparateve për tharjen e duarve në banjot në katin përdhes Komuna e Vjetër.

6.Sektori I Qendres per Sherbim me Qytetare



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA PRISHTINË - OPŠTINA PRISTINA - MUNICIPALITY OF PRISTINA



Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

01/05/2022 - 31/05/2022

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DA	Drejtoria e Administratës	5	657	590	0	0	0	0	0	12,483	13,735
DSH	Drejtoria e Shendetesise	0	100	2	0	0	0	0	0	0	102
DA	Drejtoria e Arsimit	0	137	7	7	0	4	0	0	0	155
DEZHL	Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit te Qendrueshem	0	32	0	0	0	0	0	0	0	32
DUNMM	Drejtoria per Urbanizem, Ndertim dhe Mbrojtje te Mjedisit	1	183	21	0	0	0	0	1	0	206
DIL	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit te Kontratave	0	86	13	0	0	0	0	1	0	100
DSHPMSH	Drejtoria e Sherbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpetimit	1	334	23	4	0	3	0	0	0	365
DK	Drejtoria e Kulturës	1	21	0	0	0	0	0	0	0	22
DI	Drejtoria e Inspektionit	62	277	69	0	0	0	0	0	0	408
DF	Drejtoria per Financa	25	591	8,680	0	0	0	0	15	0	9,311
DK	Drejtoria e Kadastrit	2	1,470	905	0	0	14	0	12	0	2,403
DB	Drejtoria e Bujqësisë	0	5	0	8	0	0	0	0	0	13
KK	Kabineti i Kryetarit	1	242	37	0	0	0	0	0	0	280
DP	Drejtoria e Pronës	0	40	17	1	0	0	0	0	0	58
DMS	Drejtoria e Mirëqenies Sociale	0	116	5	0	0	0	0	0	0	121
DS	Drejtoria e Sportit	0	10	23	2	0	1	0	0	0	36
DP	Drejtoria e Parqeve	0	15	3	1	0	0	0	1	0	20
		98	4,316	10,395	23	0	22	0	30	12,483	27,367